

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H 1
K

LULE DRITE

POEZI


PANDELI KOÇI

814-1
K77

PANDELI KOÇI

LULE DRITE

poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KËNGË

Për Partinë lule drite
këndona, zemër, këndona,
për Partinë, grusht çelike,
këndona, zemër, këndona.

Për Enverin rreze drite
këndona, zemër, këndona,
për Enverin zemërshqipe,
këndona, zemër, këndona.

Për Atdhenë — shullër'i diellit
këndona, zemër, këndona,
për Atdhenë kështjellë baroti,
këndona, zemër, këndona.

Si s'këndove kurrë moti,
këndona...

PËRRENJTE

Derdhen e derdhen përrenjtë malorë...
Me 25 prill 1976

buruan përrenj të rinj:
derdhi furrnalta e parë

shqiptare
përrenj të zjarrtë metali,
Peisazhi i socializmit

pa ata s'do të kishte kuptim.

FLAMURI YNË

Nga palët flakëruese liria rrezatonte,
agimin përshëndeste në shekujt errësirë...

Kur plaku patriot në Vlorë e shpalosi,
shqiptari i tha botës:
«Këtu është Shqipëri!»

Por duhej ende gjak!
Por duhej, shokë, Partia — zjarr revolucioni,
flamuri të përlindej, liria të ngadhnjente,
liria e vërtetë pa mbret edhe borgjezë!

Flamuri ynë i kuq përjetë i kuq do mbetet,
si gjaku i dëshmorëve ndër shekuj burim drite;
shqiponja jonë e lirë
përherë më lart do ngjitet —
qielli i komunizmit për të është fole.

THELLË NË ZEMËR

Pluhur verës, dimrit baltë,
verës, dimrit — djersë e artë,
thellë në zëmër — dritë e mjaltë.

Shkundim pluhurin, baltën fshijmë,
veprat rriten, vetëtijnë,
mbi gjithçka rritim Njerinë.

Esht' e çështë: dhe ujë dhe gur,
hekur-o, i shenjtë hekur
sot të kemi si askurrë.

Nuk është thjesht çelik i shkrirë,
është flamur i zjarrtë, i lirë,
ëndrra jonë e lashtë, e ddirë.

Ndaj punëtori çelik kreu,
se kërkon par mendë dheu,
do përherë mburojë atdheu.

Derdhu, rridh çelik shqiptar,
gjaku ynë je në damar
thellë në zemër: flakë e zjarr.

KJO ËSHTË NJË URË QË Ë NGRITËM PËR NJË DITË

Betononim.

Ditë dhe natë — barazi me ditë.

Harruam lodhjen, muskujt u shndërruan në shufra
çeliku;
folëm dhe s'folëm për dashuritë.

Në këmbët e urës, kurban djersa jonë.
Dhe derdhëm beton
përzier me thirrjet, këngët dhe sharjet.
(Sharjet për shefin e furnizimit, që
atë natë kishte shkuar në dasmë të
djalit të hallës e pinte raki mare
dy herë të zierë në Gostimë.)
Mbi të gjithë thërriste fjala «Furnizim»,

Hënën dhe yjtë i kishin ndërruar me projektorë.

Ulërima rrëqethëse e vibratorëve
kthehej e përdridhej në rrënkim
(dhembjet e lindjes kudo janë të ngjashme)
vetëshkarkueset vinin e shkonin,
shkonin e vinin zinxhirë.
Shkarkohej betoni me rrapëllimë,
si tej në Fierzë shkarkoheshin gurët me bubullimë.

Aty vërdallë pafuqinë e talentit ndjeu një
shkrimtar.

Përse vallë kafshoi buzët vullnetarja Norë?
Askush s'e mori vesh dhëmbjen thikë;
dhëmbja e veshkave i tha: ik!
Asaj iu saldua lopata në dorë.
(Ishte pushka e nënës shndërruar në lopatë.)

Nën këtë urë nuk kaloi ujë
po djersa jonë vullnetare,
paçka se shefi piu një fuçi me raki mare.
Nën këtë urë s'do të kaloi lum,
po treni me metal,
që si lumi valërrahur nuk fle kurrë.

U shpërnda mjegulla në agim
dhe befas

u shfaq si në përrallë
një vegim:
Ura,
ende e lagët, ende e përgjumur
si një mëz gjigand i porsalindur —
ura.

R I N O R E

Vajzat vullnetare
shinat shtrijnë çdo ditë
të të lidhin arteret
ty, Metalurgjik.

Që nga Guri Kuq
të vijë minerali
vazhdën e aksionit
ndezin porsi zjarri.

Pa lidhin miqësi
vajzat montatore
me barinjtë e bjeshkëve,
me çikat malësore.

Pa këndoijnë ndërtueset
me vajzat e jugut;
hedhin valle, hedhin,
shkrirësit e çelikut.

Lart që nga oxhaqet,
lart që nga furrnalta
vajzat kapin diellin
me duart e arta.

Metalurge quhen
edhe vullnetare
një qëllim vec kanë.
Çelikun shqiptar
të dalë i pastër,
të rrjedh i kulluar,
ashtu si ndër shekuj
kemi ëndërruar.

TASH TË KEMI . .

Dhe të kishim dhe s'të kishim,
o çelik,
sé ne ishim kaq të varfér, kaq të pasur
me armiq.

Tash të kemi se ne jemi, do të jemi
të Partisë,
porsi ti, të fortë çelik, bij
të lirisë.

P A R A T H È N I E

Ç'shi i zjarrtë derdhet nga kapriatat!
Janë shkëndija zemre montatore.
Po unë shoh mes tyre si në zhgjandër,
po unë shoh si ndrit e ndizet prore
zjarrn' e madh, pa fund tē furnaltës.

NJË PYETJE

Më pyeti im nip shtatëvjeçar:
(eh ç'pyetje bëjnë sot fëmijët!)

— Çeliku e giza

vëllezër janë,

ç'i bashkon?

Ç'i ndan? —

Me buzët dijethithëse

im nip prët, kërkon;

i téri veshë i gjallë

përgjigjen më dëgjon.

— Po, ja, — i them, e si t'ia them? —

Njeriu që zhduk në vete papastërtitë,

që djeg pa dhembje, që djeg me guxim


mbeturinë e frikë,

a s'bëhet më i mirë?

A s'bëhet më i fortë? —

Ndryshe me shkencë

s'ia shpjegoja dot



P R A P A V I J A

Brigadierit komunist N.L.

Një fjalë prozaike: kallëp.

Një fjalë e zakonshme: marangoz.

Asnjë lule nuk çel prej tyre,

asnjë zog...

E ç'lidhje ka, e ç'lidhje ti shikon
mes tyre e.fjalëve të rënda: çelik, beton ?
Na habitin korpuset, shtyllat e kapriatat,
po pelena kishin
dërrasat.

Hap projektet Niko marangozi
dhe nga letra çohen veprat në lartësi.
Shpërthen fantazia,
shatërvan shpërthen;
nga vizat e thata, nga numrat e ftohtë,
gëzimin e lindjes thellë ai e ndien.

Sharrojnë, ngulin gozhdë marangozët...
Lapsin në vesh, metrin në dorë.
Kallëpët e heshtur pa lul' e kurorë,
krijojnë ditë edhe natë
fjalën solide:

parafabrikat.

Dhe çelin prej saj jo lule e fletë.

Ngren kurmin e hijshëm,
uzinat.

Po ç'është, o shokë, kështu vallë?
Invers.
«Prapavija» hidhet në sulm, në ballë.

DHEU YNË

Dhe ynë flori
me gjak i ushqyer,
det' i djersës sonë
e bëri të vyer.

Me gjak i ushqyer
dheu ynë flori,
seç lindi një pemë,
të dashurën liri.

Det' i djersës sonë
rrënjet ia vadit
të lulëzojë e bukur,
të çeli çdo ditë.

E bëri të vyer
çdo fush' e çdo mal,
se me pun' e këngë
mbin grur e metal.

NË MBLEDHJEN E ORGANIZATËS BAZË

Pak i përkulur
sikur sapo ka hedhur beton nga lopata,
Dajë Zani ngre dorën
e bashkë me të ngrihet dhe vetë.
Dora e tij — as ai nuk e dallon dot
ku mbaron kalloja e ku fillon mishi.
Dora e tij — puna e gdhendur në pesë gishtërinj,
Mendja ia bluan mendimet si grur të pjekur,

Dajë Zani thotë me fjalët në dorë:
Qytetari ka një barrë,
komunisti dy ka pak.
Në sulm — i pari komunisti,
po «i vetmi, i vdekmi»
ndaj, sup më sup me shokët
komunisti.
E ç'peshë, e ç'vlerë ka shoku Androkli

kur brigada ku punon
planin mujor s'e realizoi?
Kur brigada s'mbuloi fondin e pagave?
Pra, legalisht vodhi!

Dajë Zani ngre dorën e ngrihet dhe vetë.
Bashkë me të u ngritën mijëra metro kub beton,
për krah tij lulëzuan me qindra themele solid,
përpara-mijëra kilometrat e shkelura prej tij
u hapën, u shtrinë....
Dhe foli me zemrën në dorë...

Po, për djalin tim student
sytë më kanë zënë lesh.
Jam treguar vetëm i ëmbël, i butë
si pulkë.
Shteti i jep treqint lek në muaj bursë, treqint,
(Vërlaci na jepte treqint dajak në kurriz).
Im bir endet bulevardeve në Tiranë
dhe mbeti në një lëndë për vjeshtë
si mbetet peshku në breg.

Dajë Zani ngre dorën
e bashkë me të ngrihet dhe vetë.
Në dorë iu shfaq
një shpatë e mprehtë

dhe foli me guximin në dorë:
Armikut të klasës me maskë, pa maskë,
i do vënë vula,
do therur në çast.
Armikut — halë në sytë
ky metalurgjik.

ATIL

I përkulur pak
sikur sapo ka hedhur beton nga lopata,
Dajë Zani punëtor,
për ty Republikë —
gur themeli.
Dajë Zani komunist,
betejë e ka çdo ditë.

J E T A

Shpatë e mprehtë s'është,
forcë plumbi s'ka,
çan shkëmbin që s'çan plumbi,
çan asfaltin që s'e pret sëpata.
Ç'është vallë kjo forcë e heshtur,
që s'e mposht as ujët, as zjarri?
Fije e brishtë, fije e përjetshme
bari.

NJERIU I RI

Sa kemi diskutuar ne për të.
Si duhet të jetë ai!?
Shpirtbukur,
mendjepasur,
trupçelik.
Dhe harrojmë ne.
se vetë ne duhet të jemi aq:
Njeriu i ri.

PËRSIATJE

Eci trotuarit i qetë;
një zhapë pjepri më përplasi për dhe.

Sikur të trembeshim,
s'do ecnim fare.

SHPJEGIM POLITIK

Në histori
ka kohë që fjala «revizionizëm»
përqaset me fjalën «tradhti»
edhe pse ka ende njerëz që s'dinë të lexojnë,
edhe pse ka njerëz që historinë s'e njohin.
Përjashto ata që historinë e lexojnë sëprapthi,
përjashto dhe ata që botën e shohin me syza të
/trëndafilta

e korbat i marrin pér pëllumba,
e prangat i quajnë tufa me lule.

Gjithsesi,
pér popujt,
pér ne
fjala «revizionizëm» — sinonim i fjalëve
«Judë» dhe «lake».

ZJARRI I MADH

Shfrytëzuesit u përpoqën me vite e shekuj,
Diellin

rreth tokës ta vërtisnin.

Dhe shërbëtorët e zellshëm i urdhëruan
me çdo kusht të lidheshin me «zotin e plotfuqishëm»;
të nënshkruanin për interes të tyre
një kontratë solidariteti e miqësie,
një kontratë të përjetshme e të pajetërsueshme.

«I plotfuqishmi», dihet, me para në dorë
u dha emrin, kryqin e gjysmëhënën
dhe s'harroi — bukën e tyre të gojës: pushtetin.
(Në emër të tij u fali
atë që kishin vjedhur)

Dhe u shit;

«i plotfuqishmi» i botës u kthye në shërbëtor.
Të shenjtit shërbëtor, apo shkurt: zotit
si resto t'i kthehej qetësia dhe errësira
për gjum.

Ikën, u rrokullisën, fluturuan
shekuj...

Bota (pér çudi!) vazhdonte tē rrotullohej rreth Diellit
e Hëna rreth Botës,
e Bota rreth vetes.
Shfrytëzuesit ndezën e ndezin
zinxhirë zjarresh tē vegjël (luftërash,
inkuzicioni...),

zjarrin e madh tē asgjësonin.

Po a mund tē shuhej ai zjarr
që ndizet në zemrat e miliona tē shfrytëzuarve?
Nga shërbëtori i shenjtë
a mund tē ndalet në postbllok tē qiellit
agimi?

C'është ky zjarr i madh që rritet e madhohet
e botën e kthen në pishtar?

C'është ky zjarr i madh që ndrit
nga viti në vit, nga shekulli në shekull?
Marksi ngre kokën diell

në horizont tē epokës së re:

«Eshtë lufta e klasave — Revolucioni».

I shenjti shërbëtor
(i ashtuquajturi i plotfuqishëm).
thërret e cirret:
«Eshtë zjarri i ferrit! Mallëkuar!...»

Me thika e sëpata,
me plumba e helme,
më raketa e atom
shfrytëzuesit turren...

Në sulm të dëshpëruar për jet'a vdekje
zjarrin e madh ta shuajnë, ta zhdukin.

Ujët që hedhin, kthehet në benzinë,
luftërat që ndezin u përvëlojnë duart,
era që mbjellin, kthehet në tufan.
Revolucioni për ata merr fytyrën e vdekjes,
për ne
fytyrën e jetës mban.

MBI GOLIK SI YLL QËNDRON

Dëshmorit Polo Bezhani

Atje lart, në atë rrëzë
përmbi Drinosin¹⁾ e gjelbër
struket thellë si fole bletësh
fshat i bukur, i egër.

Atje lindi Polo trimi
n'ata gurë i vau kërcinjtë;
brodhi Pënjes e Fracilës²⁾,
Gurrës akull lau sytë,
Në Ballhënë³⁾ ia merrte labçe,
hapsorkadh e zëbilbil;
thoshin pleqtë: «Rrofsh, o Polo,
në çdo zemër lule mbill!

1) Drinosi — degë e lumit të Vjosës

2) Pënja e Fracila, 3) Ballhëna — vende në fshatin Lekël.

Ty të kemi djalë të ditur,
ty të kemi guximtar,
rrofsh sa mali i Golikut,
që me gjak e kemi larë!»

Kur armiku, — ujk i vjetër,
shkeli vendin anembanë,
u ngrit Poloja me shokë:
«Do luftojmë! — njëzëri thanë. —
Përse Gurra s'buron ujë,
porse gjak të kuq po nxjerr?
Eshtë gjaku i të parëve,
si kushtrim të gjithë na ndjell.»

Dhe u ngrit kjo çet' e Rrëzës,
(në çdo gur një amanet)
shkëlqen Polo leklioti,⁴⁾
komisar i parë në çetë.
Dhe lufton dhe gjakun derdh,
yll' i kuq në ball' i ndrin.
Që nga Kodra⁵⁾ në Delvinë
çan përpara, çan e prin,

4) Lekëli, 5) Kodra — fshatra të Rrëzës, krahinë e Tepe-ljenës.

Ç'ka Goliku që borë s'mban,
ç'ka Nanaja⁶ që rrënkon?
U vra trim Polo Bezhani,
mbi Golik si yll qëndron.

6) Nanaja — kështu e thërrisinin të gjithë në fshat në-nënen e Polos.

MOTIV KAÇAKËSH

Popullore

Do të marr martinë,
do të dal nga malet,
t'i thérres bandillit,
vallë, mos më ngjallet.

Do të marr martinë,
do të dal nga brigjet
t'i thérres bandillit,
vallë, mos më përgjigjet.

Do të marr martinë
trimi po s'u ngjall,
me martin' e tij
hakun do t'ia marr.

Do të marr martinë
po s'u ngrit ai;
do rrëzoj dhe yjet
për ty Shqipëri.

INTIME

SHIGART

Babai im, babai im,
komunist i vjetër, partizan i heshtur.
Në heshtje luftoi, në heshtje u vra,
komunist i vjetër, partizan i heshtur.

As varrin s'ia di
unë djali kërthi, èndërr e babait.
Baba s'të kam njojur,
kushedi se ku:
Partizan pa emër.

Por në zemrën time
emër përmbi emër.

Э М И Т И

Т R A D I T É

Në qafë të Lenies mbuluar një metër me borë të
mbi shkëmb nxënëset e shkollës këndonin.
Marshonim ne në gjurmët partizane
e nxënëset na përcillnin me këngën e lashtë
(dëgjuar nga nënat e tyre e nënat nga nënat
e tyre):

*E mban mend ç'të patëm thënë,
o i shtrenjtë, o ynë vëlla...
Këtu era fjalët i shpleksi, i shoi.
Pastaj mes grushteve të borës
fjalët u lidhën fort dorë pér dore
dhe borën përreth e shkrin:*

*Tri motra të rrinin pranë,
e madhja të mbante shajaknë,
e mesmja të mblidhët gjaknë,*

*e vogla tē tha një fjalë:
Do vishem do bëhem djalë,
do këpus kopsat e jekut,
do t'ia bëjë fishek dyfekut...*

Ne, kënga e lashtë me zërin e hollë
në vend na mbërtheu;
kënga betim, kënga kushtrim
gjakun ndër deje
na zjeu...

Kemi pasur vajza tē valëve,
dëgjuar kemi pér vajzat e Sulit,

legjenda na flet pér shkëmbin e vajeve,
kënga na kujton vajzat e pushkës,
që krahët i kthyen valles së vdekjes,
që thatë i lanë magjet e bukës,
që lotë plumbash lëshuan nga sytë
kur etrit e vëllezërit ndër duar u ranë
luftërave...

Si roje e këngës —
një plakë e thatë, një nënë e fortë
qëndronte atje lart mes nxënësve,
vajzën e saj dëshmore tē shihte
mes nesh, «partizaneve».

AUTOBIOGRAFI

Kur u linda unë

Partia,

megjithëse tre muajshe m'e madhe se unë ishte,
në agim të Shqipërisë si diell

qëndronte.

Atëherë fashizmi me retë kish lidhur marrëveshje.
Shqipërisë së kuqe t'i mbyllte dritaret e qillit.
Dhe vetë dimri mërdhinte përjashta,
dhe vetë shiu u mërzit së qari.

Atëherë dhe unë ia nisa këngës
me qarje çjerrëse, monotone,
unë djali i Mihalit,
i pari dhe i fundit.

Ndërsa tokën ushqente frym e shtrëngatës,
befas, për një çast, reja u çा.
Mes perdeve një copë ballomë dielli
ra mbi fytyrën time të kuqe, të kuqe.

Me buzët e dëshirës e putha
dhe qesha.

Nëna ime fanatike u drodh;
dorën zgjati.

Diellin më vodhi ajo që jetën më fali.

Po babai im i pashëm, i shëndetshëm:
«Hapni dritaret, — foli, — hapni dritaret!
Ai është bir' i diellit!

Një copë diell i digjej në zemër
dhe në gjoks të armikut e derdhë si plumb,
sa errësira e mbylli.
në errësirë.

Por drita përhapej që përhapej....

Në gjakun tim
Diellin ai la.

KËNGË MAJEKRAHI

Çohuni, çohuni, çohuni burra!...

Krajli na ka ra
nga Qaf' Agri deri n'Leqe t'Hotit.

Leni kërraba e parmenda,
nga kosheret kanë dalë bletët.

Pushkët ende s'janë ftohur
nga përlleshjet me osmanët.

Prapë të skuqen, copë të çahen,
më i fortë është ashti ynë.

Çohuni, çohuni, çohuni burra!...

ribon i mbretëq epi le ptiq tigjet fluv-stav
zinhmash — libnul e shtj. ekipit
Kemillberet emt moshen
:dodog
qasal spaq mi temeta flisip e 'not'
shash i emt zosht qend fushata ërmik

THIRRJA E FUNDIT

Ti ishe burri i ndershëm, Mehmet Shpend,
ti ishe luftëtar.

Kundër sulltanit e krajlit ngrite
hutën e lirisë.

«Djelmënia e Shalës» që quajti «baba»,
me ty në krye — një hark triumfi pushkësh,
hark turpi e ktheu për 1500 vojnikët e krajlit.
Me ty në krye, Dukagjini,
digë iu bë vërvshimeve të turbullta,
bashkë me ty Dukagjini,
mur kalaje iu bë Shqipërisë.

Po ti mbete rob i kanunit, Mehmet Shpend,
krajlit të pabesë, i besove,
Kanuni për ty u kthye në pranga,
(më kot zemërimi yt ulërinte në kafaz)
kanuni për krajin u kthye në sëpatë.

Valë-valë nëpër vite si një pendim i madh
thirrja jote e fundit — kambanë,
ushton me fërsëllimë,
jehon:
«Tok' e qiel, amanet iu paça lanë,
kurrë anmikut besë mos me i zanë»

DËSHIRE LABI

Sipas një kënge të vjetër popullore

Eja, nuse, shkojmë në mal
të sodisim Labërinë,
mjaft i pamë kësulëkuqtë*),
që na shkelën Shqipërinë.

Ja, shiko pértej nga Çika
labëreshkat lulestralli,
plot me akth e trendelinë
seç po zbresin varg nga mali.

As e ngrem dhe ne shtëpinë
n'ato maja afër diellit,
shokëri të kemi shqipet
edhe fqinj yjet e qiellit.

*) kësulëkuqtë – pushtuesit turq.

Gjak tē lirë atje tē lindim,
trim komita mjekërgjatë,
zot tē maleve tē jenë
që luftojnë dit' e natë.

Eja, nuse, shkojmë në mal
tē sodisim Labërinë,
mjaft i pamë kësulékuqtë,
tē luftojmë pér lirinë.

RENEGA TÉVE

Dalin nga fjalimet hipnotizues
pëllumbat prej letre të Hrushovit.
S'arrijnë të hapin krahët;
nga zjarri i pashuar i luftërave klasore
digjen, mbeten hi.

Era e revolucionit
çan me grushta,
shpérndan me tèrbim
smogun*) e tradhtisë.

(*Re e dëndur e formuar nga pluhurat e gazrat indu-*

**) Re e dëndur e formuar nga pluhurat e gazrat indu-*
striale.

SATIRË

Burokratë dihet që ka
po asnjë burokrat (bile as ai më i krimbur)
nuk e quan veten sado pak
me fjalën e damkosur

«burokrat»,
dhe asnjë prej tyre s'e ka të shkruar këtë fjalë
në jakë apo në ballë.

Cili burokrat e quan veten burokrat?

Askush.

Hidhet, ndizet, bëhet prush;
ta vërteton

(po deshe dhe me dokumente ta verifikon.)
se për çdo aksion ka raport mjekësor,
se në çdo manifestim ka mbajtur flamurin
si trim,
se....

Po deshe, tē vērtetēn tē zbulosh,
nē ēshtē kallp apo ar,
vēre nē zjarr.

Çoje ta nxjerrē bukēn vetē
mbi mal, nē fushē, apo nē det.

BLETA, ARËZA DHE LULJA
MISHNGRËNËSE

fabulë

Disa lule mishngrënëse
lulëzojnë diku në botë,
në mes luleve të thjeshta
vezullojnë ngjyra plot.

Një ditë arëzën dhe bletën
etja shumë i kishte marrë,
kur papritur shohin lulen
mbushur lëng dhe nektar.

Zukat arëza e habitur:
— Ah, moj motra bletë, ç'fat!
Hidhu shpejtë barkun ta mbushim!
Mjaltë këtu ka me lopatë.

Lulja ngrënëse tha buzëqeshur:
— Me gjithë shpirt mjaltë ju dhuroj. —
Me gëzim petalet hapi;
më shumë lëngu vezulloi.

Shtangu bleta e menduar;
i pat thënë nëna dikur:
«Eshtë një lule që fal mjaltë,
po prej saj nuk del dot kurrë».

Dhe i tha kjo bleta arëzës
si të ishte plakë e vjetër,
— Kur të fal armiku mjaltë,
helmin brenda ka patjetër.

Porse arëza e pangopur
tha me thumb e paturpësi:
— Eshtë m'i ëmbël mjalt' i botës
se ai që ke në shpi.

Sa u fut në gji të lules,
ulëriti e tmerruar;
u mbyll lulja si një grackë,
mbyti arëzën e mashtruar.

FABULË AKTUALE

I tha peshkaqeni shokut të tij peshkaqen:
— Më duket, vëllaçko, bota prapa na ka lënë.
Kanë dalë ca lloj peshkaqenësh të rinj,
e di? Oqeane e dete shkelin si stuhi.
Ata s'kanë si ne dhëmb të fortë, të mprehtë,
po topa e raketa, aeroplanë mbi det. —

Iu përgjigj peshkaqeni shokut të tij peshkaqen:
— Vëllezër më të dashur në botë nuk ka ku gjen.
I kam parë e i njoh, o mik, më parë se 'ti;
natën puthen ëmbël, ditën grinden si minj.
Unë, dy pikë ujë nga njëra tjetra i

/dalloj lehtë,
këta dy miq s'i dalloj sikur të vë dhe lentë.

GRUSHT

U ngrit një mi
me emrin Marshe,
ta hapte desh,
ta shtrinte
grushtin mal
të klasës punëtore.
Pëllëmba e shtrirë
të lypte lëmoshë,
të lypte mëshirë,
në të të pështynte
borgjezi dhjamosh,
egërsirë.

Jo, more mi
me emrin Marshe,
që zhgryhe bërsive,
as gjyshërit e tu,

Breshtajn e Kautsk,
as etërit e tu,
Trock e Hrushov,
as shokët e tu,
Brezhnjev, Berlinguer,
s'harritën jo,
e kurrë s'do harrijnë,
revolucionin
ndër këmbë ta shtrijnë.
Ti mund të gërvishësh,
ti mund të pickosh
por si paraardhësit,
por si çdo mi
në llum e pleh
do përfundosh.

Me fjalët helm
veç veten gënjen,
se gjuha e blerë
në varr do të shpjerë.
He, dridhu Marshe,
përpëlitu Marshe!
O mi borgjezie.

NJË BOTË NË RËNIE

Dhe shkoi poeti në Amerikë, por
kapelja nga koka s'i ra
duke parë kulmet e gradaçielave;
si drogë, reklamat e dritat shumëngjyrëshe

s'e dehën,

Luzma e pafund e makinave
vrapin e minjve i kujtoi.
Njerëzit shpejtonin, por ai shihte qartë
si hiqnin zvarë, lidhur këmb'e duar
të padukshmet pranga.

«Vendi i mundësive të pakufizuara».

Këtë parullë poeti e përktheu me gjuhën
e së vërtetës:

Vendi i pamundësisë për të jetuar si njeri,
vendi i pamundësisë për të qenë njeri.

Mbi statujën e lirisë kishin çmonquar diellin
dhe ai pa qartë se si në vend të tij,
dollarin e verdhë kishin mbërthyer.

Aty ai e ndjeu thellë se si mes atij marramenthi his-
terik
(mbiquajtur era e kozmozit, shekull atomik)
s'mund të lindte tjetër
veç raketa e bomba për të vrarë Lirinë,
veç xhez e narkotikë për të shtazëruar Njerinë,
veç përbindësha për të shëmtuar Bukurinë.

Me sytë e imagjinatës poeti pa Romën e Neronit,
me sytë e ballit shikonte Amerikën
e Dallesit, Niksonit, Fordit.
Kohë të ndryshme, botë të ngjashme.
Ndërsa vështronë me përgjim
flakërimet e reklamave një mbrëmje,
pëshpëriti sarkastik epilogun e pashmangshëm:
Një botë në rënje.

P O N T I S T I

Sa agime tē kristaltë,
sa muzgje tē purprt
priti majë pontit¹⁾ tē lartë.
Atje qëndron si karakoll i naftës
në atë piedestal hekuri,
astr²⁾ duke futur në grykën e pusit,
(po jo si fuste gjylet topçiu i regjur
në grykën e topit antik).

Fytyrën e ka akull,
muskujt i ka zjarr;
zēmrën e ka zjarr.
Dhe puth ai agimet,
dhe pérshëndet muzgjet ai.
Djersa e pérzier me vesën e agimeve
fytyrën e ashpër ia lan;

1) Ponti — Pjesa e sipërme e pusit tē shpimit.

2) Astra — tuba shpimi.

erërat e muzgut fishkëllejnë në hekura,
ia rrahin gjithë trupin e lodhur.

Dhe ja, një çast
ai ëndërron:

«...Iliri i vogël me Shpresën e mirë
po lozin, po qeshin në dhomën e ngrohtë...
Trokët ai në derë,
i biri, e shoqja shkëlqejnë,
i hidhen, i futen në gjii...»

Dhe grushtin e fundit, të japim!
Nga poshtë gjëmon një zë.

Përmendet pontisti,
mbledh forcat.

Si bajonetën në gjoks të armikut,
astrën e fundit vendos.

QË NAFTA TË RRJEDHË

Marinëza —

një yll i hekurt kullash nafte,
që shtrihet si vala te ti Myzeqe.

Marinëza —

Balt' e llucë, pellgje naftë,
një këngë ia thotë ashtu rrëmbyer
nën diell e hënë,
nën ngricë e mjegull,
gjithmonë pa pushuar
si zemra.

Që nafta të rrjedhë, të rrjedhë, të rrjedhë
si gjaku ndër deje, si valët e lumit,
kokoren e çizmet, mushamanë e zezë
jo kurrë s'do t'i heqë nga trupi punëtor
naftëtarja Marinëz!

Që nafta të rrjedhë, të rrjedhë, të rrjedhë,
armiqtë,

që ropateshin naftën pérjetësish ta varrosnin,
në naftë i varrosëm,
i hodhëm tej detit,
i shporrëm tej maleve.
Çdo pus buron
naftë e vigjilencë.

šfusl tsiv orh aqedov os
nukov duktibz u duktibz os
TURNI I TRETË

Eshtë natë; në palcë të ftohit
të hyn thellë, frymën të merr.
Hëna qan në pikë të lotit,
ëndërron të ngrohtën verë.

Erë e diellit¹⁾ fryn e fryn
edhe mblidhet, dridhet fusha;
zhubra-zhubra ujët ngrin,
qajnë kaçullat²⁾ në gëmusha.

Ngrihen vetëm kryelartë
kulla nafte-skelethekur,

1) Era që fryn nga lindja.

2) Zog fushe

seç verbojnë dhe yjet lartë
me këmishë dritash veshur.

Sonda, vulfa e traktorë
gjumin natës po ia prishin,
Gulçojnë rëndë e rëndë motorët,
erën vetë në garë e grishin.

Por mbi kulla e aggregatë
kush qëndron ashtu i heshtur?
Naftëtari lyer naftë —
ballin lart në yj mbështetur.

NË K L U B

«Le t'i kemi pérherë gotat plot!» — uroi shoku im,
«Le t'i kemi pérherë vaskat plot!» — urova dhe unë.
Dhe shokët e tjerë naftëtarë të veshur me gëzim,
urime të tjera ngritën pér gratë e urta,
pér fëmijët e shëndetshëm (më të zgjuar se ne),
pér vajzat e bukura që çelen këtë pranverë.
Kurse kryesondatori ynë, një cigan i vërtetë,
(baba i shtatë fëmijëve)
thirri:

«Nafta-lumë,
gjalp e mish përmot më shumë!»
Nuk ka urim më të bukur pér ne
«Nafta-lumë....»

Është ditë e rrogave sot.
dhe me plan këtë pesëmbëdhjetëditësh
s'kaluam keq.
Të ulur të gjithë mbi krahët e dëfrimit

në klubin e kantierit
naftën në gota e kemi kthyer në verë.
Gazi ynë i çiltër, legjitim
është si gaz i fëmijëve që los me pëllumba,
është si gaz i diellit në perëndim mbi det
që shkon të çlodhet për t'u çuar
nesër në agim.

P È R T È R I T J E

Zemérngazëllyer pranverën dal e pres,
këtë virgjëreshë hirëplotë e tërë dritë,
e puthjen e parë në lule un' i fal
qilimit drit' e ngjyra që lulëzón çdo vit.

E zemra e dehur, e qeshur, zjarrndezur
e lehtë si pëllumbi i jep krah fantažisë,
për ëndrra të bardha, për ëndrra dashurore,
për hove rinoare nën qiejt' e lumturisë.

Zemërdashuruar pranverën dal e pres
mbi kodrat vesh n'blerim hap gjoksin i gëzuar
e flladi i lehtë më puth, më përkëdhel;
zemra gufon, këndon nën tinguj t'mrekulluar

Gjaku dejeve më rrjedh si bora maleve
e muskujt më mbushen plot fuqi të re;
qilizëm të hapim, të çajmë vetullore,
pranverë të përhershme të kemi ty, atdhe.

Zemërpërtëritur pranverën dal e pres...
O, mirë se erdhe, mirë se erdhe përsëri,
o mik, e rinisë, o motër e rinisë,
o gaz' i tokës: pranverë e dashuri.

LULE NË BJESHKË

I

— Unë, o shokë, do dal vullnetar, —
thashë një ditë në uzinë mes shokëve.

— Unë do dal, o shoqe, vullnetare, —
tha ajo në shkollë mes shoqeve.

Kur në mbrëmje u takuam,
s'u çuditëm që thamë të njëjtat fjalë,
zemrat tona këndojnë veç një këngë
si lulebore do çelin lart në mal.

Dashuria është zjarr që të ngroh,
dashuria është zjarr që të ndrit,
të jep krah në sulm të hidhesh,
atje ku ne po ngrejmë mrekullitë.

Veç ajo nuk tē le tē mbyllesh
si kërmilli fshehur nē guackë:
brenda dhomash shtruar me qilima,
zjarrn' e zemrës ta shuash pak nga pak.

II

Bjeshka e lart na priti krahëhapur
me kore bilbilash, aroma çaji,
ujvara kristal na thurrte ylbere:
Mirë se erdhët tek ne këtë ditë maji.

Shokë e shoqe dolëm lart nē male,
dhe djersën ar e derdhim mbi çdo gur:
të lulëzojnë ëndrrat si lulet bjeshkëtare,
mbi çdo shkëmb e shkrep tē rritet kudo grurë.

Dashuria éshtë zjarr që tē ngroh,
dashuria éshtë zjarr që tē ndrit,
tē jep krah, nē sulm tē hidhesh
atje ku ne po ngrejmë mrekullitë.

VAJZA DHE ÇELIKU

Tek ne erdhi një ditë
një vajzë në fonderi;
u tremb, u skuq nga flaka,
e dogji një shkëndijë.
Vështroi duart tonë,
të nxira janë ato;
po sytë na ndrijnë të qeshur,
ndaj qeshi dhe ajo.

II

Dhe shfryjnë, gjëmojnë furrat
dhe derdhet djersa valë;
çeliku ynë i shkrirë
si dielli i ngjan.
Një valle fishekzaresh
si flutura ylberi,

pa dashur shpejt e joshi,
se s'ishte gur mermeli.

III

I tha çeliku vajzës:
Shikoma zemrën, shoqe,
e kam të zjarrtë, të pastër
e djeg çdo zgjyrë e skorje.
Kjo zemra jot'e vogël,
këtu do vetëtijë,
do mbushet zjarr e dritë,
do flak çdo mbeturinë.

IV

Dhe shfryjnë, gjëmojnë furrat
dhe derdhet djersa valë,
çeliku ynë i shkrirë
si dielli i ngjan.
Dhe ra në dashuri.
mes flakëve atje
e tok me çelikun,
u bë një shkrirëse e re.

V

Në gjirin tonë punëtor
lulëzon ajo përherë,
shkëndijat rrëth e qark
si lulet në pranverë.
Vështroi duart në punë,
të nxira janë ato,
po zemra metallurge
si diell ndrit ngado.

D A S H U R I

Thonë metali është i ftohtë,
zemra ime jo se jo;
thonë metali është i fortë,
duart' e mia shkrijnë çfarëdo.

Dhe ti s'je as gur as dyllë,
dhe ti s'je as mineral;
shkurt e thjesht: shkrirëse çeliku,
porsi unë, shkrin metal.

Po çudi, moj Zanë, çudi!
Ti më njeh çfarë forcash fsheh.
Si nuk mundet dot të shkri
zemrën tënde metalluge?

Fjalë të bukura s'mund të them,
(do të dukeshë llafazan)
veç me sy të shigjetoj,
veç në zemër ty të kam.

Po së fundi ja, e gjeta
pikn' e shkrirjes dhe tek ti;
çelësi artë ishte guximi —
çdo gjë troç ta thashë në sy.

VAJZA ME ÇEKIÇ

...Dhe troket, troket çekiçi,
gjurmë lë përmbi struktura,
Nga kapriata në kapriatë,
nga kolona në kolonë
hidhet vajza me çekiç
dhe godet

provon ajo:

Çfarë cilësie ka betoni?
Cilësinë e ndërgjegjjes.
Si përpinqet specialisti?
Sa djersitet muratori?
C'sy e vesh të mprehtë ka vajza
që godet përmbi betone?
Ndaj troket, troket çekiçi
mbi ndërgjegjje e betone.

Po një ditë çekiçi mbeti,
pezull mbeti pér një çast.
Pérmbi traun njëzet metersh
gjurma ishte jashtë standartit.
Këtë tra e kish prodhuar
vëllai i vajzës kontrolllore.
Po ndërgjegjja s'do t'ia dijë
pér vëlla, a pér baba;
shënjen «skarco» shënon vajza:
«Turp të kesh, o im vëlla!»
Godet fort çekiçi i motrës
mbi ndërgjegjjen e vëllait.

...Dhe troket, troket çekiçi,
gjurmë lë pérmbi struktura.
Çfarë cilësie ka ndërgjegjja?
Cilësinë e betonit.

PAS TETORËSHIT

Në orën tre le punën.

«Nesër, — mendoj, — duhet të nxjerr tre boshte më
tepër.»

Duart laj fort,
megjithëse rrëzë thonjve do mbeten përherë
gjurmë grasoje.

I jap biçikletës me ritmin e zemrës,
këmisha gufohet,
dëshirat vrapojnë përpara biçikletës,
turren si bletë të dehura mbi lule,
vrapojnë si fëmijë në rrah' e lëndina,
notojnë si detarë mes dallgëve magjepsëse.
Dëshirat apo duart timonin e drejtojnë?

Vrapoj...

Pranvera brenda meje lulëzon asfaltin,
bleron trotuaret, pallatet dallgëzon.

Pse kaq të dashur, pse kaq të afërt,
pse kaq të qeshur njerëzit më duken?

Pse bicikleta anë trotuarit frenoi?

Flokët e saj u ngatërruan në telat e rrotave...

Ajo buzëqesh me një premtim të bukur në sy,
ajo që më ngatërrohet aq shpesh në xhirot e frezës,
ajo që me vete e pëshpërisim «e dashur».
po në sy i flasim me emër.

Ndërsa i them fjalë që janë baraz-me zero,
dëshira më thotë: Shtegto bashkë me të
në parkun me pemë, me lule e liqen;
thith ajër të pastër e dashuri.

Po para syve, i ftohtë, i rreptë
ç'më hape kështu sot
ti libër mekanike!

Dashuria më josh si di ajo të josh,
problemi më urdhëron: O sot, o kurrë!
Të dashurën të lë të kap mekanikën?!
Të le mekanikën e parkut të dëfrej?

Ajo pret...
e bukur, e kapshme...
Unë befas nga krahu e kap:
«Shkojmë studjojmë, e dashur, bashkë në bibliotekë;
nesër gdhin e diel.

LIRIKË MËNGJESI

Sipas një këngë popullore

C'më zu vesa në lëndinë,
më lagu fustan,
duke mbledhur tuf' me lule
për djalin azgan.

O, sa shumë që u vonova,
nënës si t'i them;
mbas' e gjej në gjum të thellë,
fjalë të mos kem.

Fjalë, fjalë që m'hëngrën shpirtin,
jo nuk dua fjalë!
Porse mikun gunëdhirtë
ta shtrëngoj me mall.

Dhe ta deh me aromë lulesh,
ta spërkat me vesë,
gjersa zemrën t'ia rrëmbej
dhe me prush t'ia ndez.

MAL MË MAL

Jeta e çobanit,
jet' e bukur shumë,
bredhim mal më mal
ruajmë dhe në gjumë.

Trëndafil agimi
shkrepet majë mali,
ne zemra na çelet
si lule behari.

Radjoja jep muzikë,
delet blegërijnë,
ne i biem culës
lëndinë më lëndinë.

Gurgullim e gurëve
nga gryka gremiset,
rrugës, buzë pérroit
ulërin... e niset...

Pranë një zhgarrëzime
tufa e bagëtive,
ne kalojmë shkujdesur
gjurmëve të dhive.

Ne kalojmë me zhurmë,
vërshëllejmë me gaz,
qentë tanë trima
heshtur na vijnë pas.

Kërrabën mbajmë në dorë,
pushkën krahëve hedhur;
pérmbi lapidarë
lule kemi hedhur.

Jeta e çobanit
jet' e bukur shumë,
nga kujdesi ynë
qumështi derdhet lumë.

K A L I M T A R E

Shi. Gjysmë thesi i çimentos në shi.
Në vrap e sipër e kapërceu tekniku,
s'e pa.
Djaloshi, që e la në shi,
numëronte pikat nën strehë.
E pa punëtorja pesëdhjetëvjeçare,
nëna e urtë, Vanthi,
hoqi nga krahët mushamanë,
qetësisht e mbuloi
si fëminë e saj.

HEROIZËM

Një jetë të tërë brenda punës u vërtit ai.
I çdoorshëm, i përditshëm, i përvitshëm,
i pa dukshëm, si buka i thjeshtë —
heroizmi i tij.

BURONJAT

Valët plot stërkala vallëzojnë këmbëzbathur,
si kuaj të harbuar vrapojnë.

Këtu në Buronjat mbuluar me rrepe,
mbi këtë çadër të gjelbërt vigane
ëndrra ime qytetin modern ndërton,
fantazia s'përfill asgjë.

Mes zhaurimës së kristaltë të valëve
(Më tepër se çdo vajzë çapkëne janë ato)
ngrihet i ëmbël,
qesh edhe loton,
dridhet i kulluar si ky fllad i freskët
zëri i këngëtarit që labçë ia ka marrë.

Valët vrapijnë në gji të përjetësisë,
Labëria plakë përkundet në kujtime.
E ashpra dhe e bukura —
bija të një néné —
vallen e hareshme
heqin majë malesh.

TALKOMA

zgjedhë pëmja që pësillen abd i cili është tili i
shumicës së vjetër. Sot qëndroj që abdi i
zgjedhë pëmja që pësillen abd i cili
është shumicës së vjetër. Sot qëndroj që abdi i
zgjedhë pëmja që pësillen abd i cili
është shumicës së vjetër. Sot qëndroj që abdi i

zgjedhë pëmja që pësillen abd i cili
është shumicës së vjetër. Sot qëndroj që abdi i
zgjedhë pëmja që pësillen abd i cili
është shumicës së vjetër. Sot qëndroj që abdi i
zgjedhë pëmja që pësillen abd i cili
është shumicës së vjetër. Sot qëndroj që abdi i

HAKMARRJA E BUKËS

Dikush e vrou Shefik aganë
ndërsa Vjosën kalonte i hipur në kalë;
në zverkun e majmur, të skuqur, tërë djersë
me thikë
i ranë.

Tim gjyshi i vunë gishtin
dhe iku ai larg në Amerikë —
vajzat la pa nënë, djalin pa baba.

Si Vjosa mbi luginë
agai kish vërshuar,
e veç si shushunjë bujqit i thithte.

Brigjet e urrejtjes, hakmarrja e bujqve
rrakte e rrikte.

E kush mund ta dijë?
Kujt ia ngriti dorën guximi i klasës?
Hasanit, Vangjelit, Mitit a Xhelos?

Kur bukë një bujk
nuk kishte të priste në sofër,
me thikën e bukës
(ç'të bënte i varfëri?)
theri aganë.

Hakmarrja e bukës shkrepëtiu mbi Vjosë.

...Dhe mbeti gjyshi asaj Amerike
me imazhin e turbulët të Vjosës ne sy,
U kthe i plakur pas dyzet e kusur vjetesh
ne ditet tanë t'jela.
Hoqi e vuri syzet e trasha
'e vetes s'i besoi.

Urrejtja e bujkut kularët e shtypjes,
përjetë i kish përmbytur.

TRI KËNGË PËR HOLTËN

1.

Eshtë një lum me emrin Holta,
rrjedh i turbullt, rrjedh i kthjellët.

Eshtë një vajzë me emrin Holta
mon e lumtur, qan e qesh

Bie shi e vrellat kohë,
turbull-turbull dardhat Holta,

Këlthet fort Holta e urtë
kur i pihet, kur s'është ngopur,

Kur mbi Holtë hëna rrëshqet,
uji i pastër buzëqesh.

Rrezaton rreth Holtësjeta
veç agime të vërteta.

Motra Holtat janë e s'janë,
Në këtë tokë rrënjet i kanë.

2.

Pérmbi Holtën, nina nana,
ëndërroj vitet e saja.

Pëllumbesh' e bukuroshe
qesh e ëmbël, sylaroshe.

Fytyrë qumësht, fytyrë jetë,
si do jetë pas njëzet vjet?

Pér të ardhmen kush kallëzon?
Pérmbi të fati s'qëndron.

Pér profet, jo, mos kërkoni,
fat' i saj — Revolucion!

Shoh të ardhmen: dritë, dritë...
Kaq shumë dritë, të merren sytë.

3.

Do shfletojë pas njëzet vjet
librin Holta fletë fletë.

Vargjet ndoshta do jenë tharë,
do jenë zbardhur e shpëlarë.

Porsi unë do jenë rrëgjuar...
E vërteta do rrijë zgjuar.

Ndaj, moj Holtë, moj pëllumbeshë,
babin tënd ti mos e qesh.

Do jesh siç kemi pritur,
më e mirë, më e ditur.

Do t'i kesh në t'gjitha frontet
më të gjera horizontet.

Ndaj gëzoj, gëzoj, gëzoj...
Larg me èndrrën fluturoj.

B E T I M I I M

Unë jam komunist,
unë jam shqiptar,
gjithë jetën valë,
gjer në vdekje —
luftëtar.

Unë jam komunist,
unë jam shqiptar,
për Shqipen me yll,
me Shqipen me yll —
gjer në varr.

Unë jam komunist,
revolucionar,
betimi im,
s'gozhdohet në fjalë.

PASQYRA E LENDES

Këngë	5
Përrenjtë	6
Flamuri ynë	7
Thellë në zemër	8
Kjo është një urë që e ngritëm për një ditë	10
Rinore	13
Tash të kemi	15
Parathënie.	16
Një pyetje	17
«Prapavija»	18
Dheu ynë	20
Në mbledhjen e organizatës bazë	21
Jeta	24
Njeriu i ri	25
Përsiatje	26
Shpjegim politik	27
Zjarri i madh	28
Mbi Golik si yll qëndron	31
Motiv kaçakësh	34
Intime	35
Traditë	36
Autobiografi	38
Këngë majekrahi	40
Thirrja e fundit	41

Dëshirë labi	43
Renegatëve	45
Satirë	46
Bleta, arëza dhe lulja mishngrënëse	48
Fabulë aktuale	50
Grusht	51
Një botë në rënie	53
Pontisti	55
Që nafta të rrjedhë	57
Turni i tretë	59
Në klub	61
Përtëritje	63
Lule në bjeshkë	65
Vajza dhe çeliku	67
Dashuri	70
Vajza me çekiq	72
Pas tetorëshit	74
Lirikë mëngjesi	77
Mal më mal	79
Kalimtare	81
Heroizëm	82
Buronjat	83
Hakmarrja e bukës	85
Tri këngë për Holtën	87
Betimi im	90